



DEKLARATË PËR SHTYP



Shqipëria do të marrë pjesë në Jurinë e Çmimit prestigjioz Strega 2016

Takim me shtypin i hapur për publikun

Në Ditën Botërore të Librit, **Instituti Italian i Kulturës**, në bashkëpunim me **Bibliotekën Kombëtare**, prezanton grupin e lexuesve shqiptarë që do të jenë pjesë e jurisë së **Çmimit Strega 2016**. Në takimi do të jetë e pranishme edhe Ministria e Kulturës **Mirela Kumbaro**.

Çmimi Strega, çmimi letrar më prestigjioz italian, u themelua në vitin 1947 në Romë nga **Maria** dhe **Goffredo Bellonci**, me kontributin e **Guido Alberti**, pronar i fabrikës së pijeve Strega Alberti Benevento, prodhues i likerit me të njëjtin emër. Çmimi i jepet çdo vit një romani, shkruar në gjuhën italiane dhe botuar gjatë edicionit të parë, mes datës 1 prill të vitit të kaluar dhe datës 31 mars të këtij viti. Votuesit e Çmimit Strega janë Miqtë e së dielës, një grup burrash dhe grash eksponentë të botës kulturore. Votimi zhvillohet në dy faza. Sondazhi i votimit të parë, për përcaktimin e pesë finalistëve, do të mbahet më **15 qershor**. Votimi i dytë dhe shpallja e fituesit do të mbahet më **8 korrik**.

Përveç *Miqve të së dielës*, grup elektoral historik i përbërë nga rreth 400 persona, marrin pjesë në këtë juri edhe 60 *Lexues të fortë*, të zgjedhur nga librashitësit në mesin e klientëve të tyre, të cilët ndryshohen çdo vit si dhe pesëmbëdhjetë *Grupe lexim* nga shkollat, universitetet dhe Institutet Italiane të Kulturës jashtë vendit.

Që nga ky vit Shqipëria do të bëhet pjesë e jurisë për Çmimin Strega me Grupin e vet të Leximit, koordinuar nga Instituti Italian i Kulturës në Tiranë. Për herë të parë lexuesve shqiptarë, të përbërë nga një mix përkthyesish, botuesish, italianistësh dhe dashamirës së kulturës italiane, do t'u kërkohet të gjykojnë romane italiane.

Fitimi i Çmimit Strega përbën prestigj të madh për veprën dhe natyrisht për autorin. Llogaritet që libri i cili ka fituar Çmimin Strega të pesë fishojë shitjet. Disa nga shkrimtarët që kanë fituar çmimin Strega:

Cesare Pavese – La bella estate, 1950

Alberto Moravia – I racconti, 1952

Giorgio Bassani – Cinque storie ferraresi, 1956

Giuseppe Tomasi di Lampedusa – Il Gattopardo, 1959

Primo Levi - La chiave a stella, 1979

Umberto Eco – Il nome della rosa, 1980

Claudio Magris – Microcosmi, 1997

Paolo Giordano – La solitudine dei numeri primi, 2008

**E premte 22 prill 2016
ora 11,00**

**Biblioteka Kombëtare, Tiranë
Hyrja e lirë**

Info

Tel. +355 4 237 9580

www.iictirana.esteri.it

Tel. +355 4 22 23 843

www.bksh.al